



Parashtruesi: **Shaip Lushaku**, me numër identifikues [REDACTED], të lëshuar nga MPB-ja, me adresë vendbanimi në [REDACTED];

Drejtuar: **Komunës së Prishtinës, Drejtoria e Urbanizmit**

Lënda: **Komente lidhur me kërkesën 05 Nr.350/02-76573/24 të datës 13.06.2024.**

Të nderuar,

Po ju shkruajë sa i përket njoftimit publik të Komunës së Prishtinës, sipas kërkesës me numër 05 Nr.350/02-76573/24 të datës 13.06.2024, përmes të cilës është kërkuar të përcaktohen kriteret e caktuara për ndërtim, përkatësisht për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e ndërtesës shumë banesore dhe afariste, në kuadër të parcelave kadastrale nr.427-13, 14, 15, 16, 17, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 65, 66 Z.K Çagllavicë, në kuadër të planit rregullues të hollësishëm “Prishtina e Re” – zona përëndim”, në Prishtinë.

Komuna e Prishtinës, në njoftimin publik ka përcaktuar se lidhur me propozimin komentet mund të dërgohen nga data 18.07.2018 deri më datë 01.08.2024, në email adresën urbanizimprishtine@rks.gov.net;

Ju njoftoj se pranë Gjykatës Supreme të Kosovës, Dhoma e Posaçme, me datë 30 shtator 2022 është iniciuar Padi për vërtetim të pronësisë, me Paditës Shaip Lushaku, kundër të Paditurës Agjencisë Kosovare të Privatizimit, dhe kjo çështje tashmë është duke u trajtuar pranë kësaj gjykate.

Padia është inicuar për faktin se mua Shaip Lushaku në bazë të vendimit mbi dhënien në pronësi të tokës nga prona e RTP-së, me nr. 02/16/427/1/15/99, si kompensim për humbjen e të drejtës së punës në RTP nga 5 korriku 1990 e këndeje pa fajin e tim, më është ndarë në pronësi prej 5,27 ari prej ngastrës kadastrale nr. 427/1, (ngastra nr.15) në vendin e quajtur “Llojze Veternik”, sipas fletësposedimit Nr. 221, zona kadastrale Çagllavicë.

Po ashtu, më datë 28.07.1999, unë Shaip Lushaku me Ndërmarrjen Shoqërore Publike, informative “Radiotelevizioni i Prishtinës”, RTP, kam lidhur kontratë mbi dhënien e patundshmërisë në pronësi pjesën e patundshmërisë me kulturë arë dhe kullosë në sipërfaqë prej 5’27 ari, ngastra kadastrale Nr. 427/1-15, në “Llojze Veternik”, Zona Kadastrale Çagllavicë.

Në bazë të Vendimit nr. 02/16/427/1/15/99 dhe kontratës mbi dhënien e patundshmërisë në pronësi, në bazë të rregullores së RTP-së për menaxhimin e pronës Nr.2/2 neni 2, pika 1, dhe në bazë të vendimit të marrë në mbledhjen e Bordit Ekzekutiv të Drejtorëve dhe Sindikatës, është bërë marrëveshje, unë **Shaip Lushaku** emërohem si bartës i të drejtës pronësore të ngastrës së dhënë, pra më jepet në pronësi pjesa e paluajtshmërisë me kulturë arë dhe kullosë në sipërfaqe prej 5,27 ari, numri i ngastrës në skicën e gjendjes faktike 427/1-15, si kompensim për humbjen e të drejtës së punës.

Mbi bazën e kontratës së datës 28.07.1999, me nenin 5, përcaktohet se kohëzgjatja e kësaj kontrate është e pakufizuar për arsye të tejkalimit të destinacionit të kësaj patundshmërie, dhe neni 7 i cili përcakton se me datën e nënshkrimit të kësaj kontrate, pronari i ngastrës fiton të drejtën e menaxhimit të pronës së dhënë, pra në këtë rast unë **Shaip Lushaku**.

Me vendimin e datës 29.10.2012, me nr. 04/68/10/012, nga RTP më është dhënë në shfrytëzim poashtu një tokë 30 ari tokë në Veternik, në Vendin e quajtur Llojze, Fleta poseduese 221, ngastra kadastrale 427/1, mirëpo me këtë vendim i është dhënë në shfrytëzim 30 ari për periudhën 1 vjeqare, ndërsa vendimi tjetër i lartëcekur me nr. 02/16/427/1/15/99, i është ndarë në pronësi, dhe në bazë të kontratës së lartëcekur, në kohëzgjatje të përhershme.

Në atë kohë për shkak të disa problemeve nuk kam arritur që të përfundojë të gjithë procedurat për kalimin e pronës me numër kadastral 427/1 (ngastra nr.15), në emër dhe pronësi timen, mirëpo përmes Vendimit 02/16/427/1/15/99 dhe kontratës së datës 28.07.1999, e cila është lidhur me vullnetin e lirë nga palët kontraktuese si dhe dëshmitë, jam pronarë i paluajtshmërisë së lartëpërmendur.

Në këtë drejtim, duke e pasur parasysh që Vendimi me nr. 02/16/427/1/15/99 dhe Kontrata janë realizuar konform obligimeve ligjore dhe obligimeve kontraktuale të cilat kanë rrjedhur për përmbushjen në tërësi të së njëjtës dhe nga pamundësia ime që pronën në fjalë t'a evidentoj në emër të tim, jam obliguar që njohjen e pronës ta kërkoj përmes rrugës gjyqësore, në mënyrë që të i mundësohet evidentimi në regjistrat kadastral pranë Komunës së Prishtinës.

Andaj, duke qenë se për çështjen në fjalë është duke u zhvilluar procedurë gjyqësore pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, kërkojë që të ndërpritën të gjitha procedurat e dhënies së lejës për ndërtim për ngastrat e përcaktuar edhe në njoftimin publik të Komunës së Prishtinës, deri në vendosjen meritore të çështjes nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Me respekt,

Shaip Lushaku

